



Република Србија

Координационо тело Србије за општине Прешево, Бујановац и Медвеђа

3. mars 2009.

Informatat mbi aktivitetet e Trupit koordinues (shtatorë 2008-mars 2009)

Pas formimit të Qeverise se Serbise dhe emerimit te Milan Markoviq per minister te qeverisjes lokale si dhe per kryetare te Trupit Koordinues, jane definuar keto prioritete:

a) Nga sfera politike

- Kyqja e perfaquesuesve politik shqipetare ne punen e Trupit Koordinues, rekonstruimi i Trupit Koordinues dhe permiresimi i efikasitetit ne pune.
- Rekonstruimi i qeverisjeve lokalene Presheve dhe Bujanoc, me perfaqesimin e barabarte te te gjith bashkesive etnike

b) Ne sferen e ekonomise

- Terheqjen e investimeve,
- Kyqjen e Presheves, Bujanocit dhe Medvegjes ne projektet e ndryshme finansiare si te vendit poashtu edhe ne ato nderkombetare.

c) Ne sferen e integrimeve

- Hapjen e institucioneve te larta shkollore ne Medvegje, Bujanoc dhe Presheve me mesim ne gjuhen shqipe,
- Zgjidhja e problemit te perfaqesimit te shqipetareve dhe romeve ne instancat me te larta republikane ne nivelin lokal (shendetesi, shkollim, gjyqesi etj).
- Angazhimi ne mbrojtjen e te drejtave te njeriut (hapja e zyres per mbrojtjen e te drejtave te qytetareve-Ombudsmani)
- Finansimi i projekteve per rinine.

d) Ne raportet nderkombetare

- Promovimi i aktiviteve te Trupit Koordinues si dhe koordinimi me i mire me partneret nderkombetare.

e) Ne komunikimin publik

- Transpariteti i punes se Trupit Koordinues
- Komunikimi publik me: a) qytetare, b) mediat, c) perfaquesuesit politik, d) perfaquesuesit nderkombetare

Aktivitetet kryesore te Trupit Koordinues ne periudhen shtatore 2008 - mars 2009

Ne sferen politike:

- Qeveria e Republike se Serbise ne gushte te vitiit 2008 emeroi Milan Markoviq, minister i pushtetit lokal dhe veteqeverisjes lokale per Kryetare te Ttrupit Koordinues. Kryetari i posaemeruar i Trupit Koordinues paralajmeroi prioritetet strategjike dhe ate para se gjithash nga sfera ekonomike, arsimi dhe puna me rinine. Jane emeruar edhe nenkryetaret e Trupit Koordinues (Dushan Spasojeviq, Ministria e mbrojtjes, Dejan Jovanoviq, Ministria e ekonomise dhe zhvillimit regional si dhe Sima Gazikaloviq).
- Perfaquesuesit e Trupit Koordinuas, pas emerimit te Milan Markoviq per kryetare te Trupit Koordinues, perpos komunikimit me zyrete e saje ne Presheve dhe Bujanoc, dy here ne muaj eshte takuar me kryetaret e ketyre dy komunave si dhe me perfaquesuesit politik serb dhe rom.

Тел: 011/ 21 20 906; 011/ 21 20 907

Факс: 011/ 21 20 909

E-mail: office@kt.gov.rs

www.kt.gov.rs



Република Србија

Координационо тело Србије за општине Прешево, Бујановац и Медвеђа

- Sherbimi i Trupit Koordinues ne bashkepunim me organet e veteqeverisjeve lokale, perqatit propozim reorganizimin e Trupit Koordinues e cila do tu mundesoje perfaqesimin e te gjitha bashkesive ne Trupin Koordinues.
- Strategjia e punes se Trupit Koordinues 2009-2011- Ekipi i eksperteve te Trupit Koordinues mbaroi plan projektin e strategjiise se punes te cilin pastaj e dergoi ne adresat e Presheves, Bujanocit dhe Medvegjes. Pas sygjerimeve dhe komenteve, ekipi i eksperteve do te mbaroje strategjine e cila pastaj do te dergohet ne shqyrtim publik. Sipas marreveshjes, ky plan projekt duhet te pervesitet ne bashkepunim me te gjithe perfaqesuesit relevant te ketyre tri komunave.
- Bisedimet rreth kyqjes se Serbeve dhe Romeve. Gjate vizites se dyte te Bujanocit dhe Presheves, kryetari i Trupit Koordinues potencoi rendesine e principeve multietnike ne qeverisjen lokale. Njera nder kerkesat kryesore eshte kyqja e perfaqesuesve serb ne qeverisjen lokale qe te vije deri te reflektimi i multietnicitetit ne komuna.
- Sherbimi i Trupit Koordinues perpunoi buxhetin per vitin 2009 ne te cilin eshte parapare mundesia e ndihmes se drejtoperdrejte komunave, mjete per pune me rinine, organizatat joqeveritare, ndihme sociale si dhe zhvillimi ekonomik.

Nga sfera ekonomike:

- Miniera Leqe eshte privatizuar me sukses. Sipermarrja private Farmakom nga Shabaci eshte e interesuar per te vere ne fungsion prodhimin e kesaj miniere. Gjithashtu kjo kompani e cila eshte pronare e qumeshtores se Shabacit eshte e interesuar per investime ne blektori. Trupi Koordinues ndermjeteson ne komunikim mes organeve shteterore dhe fondit per zhvillim duke mar parasysh rendesine e minieres per komunen e Medvegjes si dhe tere regionit. Pritet qe ne kete miniere te punesohen deri ne 500 punetore nga komuna e Medvegjes.
- Trupi Koordinues ka perfshire edhe perfaqesuesit e Presheves, Bujanocit dhe Medvegjes ne trajnimin e promovimit te komunave te cilin trajnim e percjell Banka Boterore ne bshkepunim me Agjensionin per investime nderkombetare dhe promovimit te exportit (SIEPA). Pas ketij trajnimi, Trupi Koordinues ne bashkepunim me USAID-in, programi i zhvillimit ekonomik te komunave (MEGA) organizoi trajnimin nga i cili perfaqesuesit e Presheves, Bujanocit dhe Medvegjes do te marrin njohuri rreth prezentimit sa me efikas te komunave per investime nga ana e institucioneve qeveritare te qeverise se Serbise dhe institucionet nderkombetare. Ne keto trajnime, perfaqesuesit e Presheves, Bujanocit dhe Medvegjes bashkepunuani me expertet per zhvillim ekonomik lokal te Kragujevcit dhe Lloznices.
- Ne nentore te vitit 2008 eshte nenshkuar Marreveshja rreth bashkepunit ekonomik ne mes te Trupit Koordinues, Agjensionit ekonomik Amerikan per zhvillim nderkombetare (USAID) dhe komunave te Presheves, Bujanocit dhe Medvegjes. Me kete marreveshje komunat e Presheves, Bujanocit dhe Medvegjes jane kyqur ne Programin per zhvillim ekonomik te komunave (MEGA).



Република Србија

Координационо тело Србије за општине Прешево, Бујановац и Медвеђа

- Ne Bujanoc, Presheve dhe Medvegje hapen zyre lokale per zhvillim ekonomik (ne baze te marreveshjes se nenshkruar permes te komunave, Trupit Koordinues dhe USAID-it) si dhe formimi i keshillit ekonomik ku jan te kyqur perfaquesuesit e sektorit privat dhe pushtetit lokal.
- Ne tetore te vitit 2008 Kryetari i Trupit Koordinues Milan Marković dhe Ministri i Bujqesise Sasha Dragin vizituan komunat e Bujanocit dhe Presheves ku me kete raste dhuruan ndihme nga ana e Ministrise se Bujqesise dhe ate: fare te grurit (Bujanoc: 120 familje; Presheve: 80 familje dhe Medvegje: 40 familje); fidane perimesh (Bujanoc: 250 pakete; Presheve: 180 pakete si dhe Medvegje: 70 pakete) dhe theker (Bujanoc: 10 familje; Presheve: 6 familje si dhe Medvegje: 4 familje).
- Gjate vizites se Bujanocit dhe Presheves ne nentore te vitit 2008, delegacioni me sekretarin e Ministrise se Ekonomise dhe te zhvillimit regional ku mori pjese edhe Ministri Dejan Jovanovicin (i cili eshte njehrit edhe nenkryetare Trupit Koordinues), kryetari i Trupit Koordinues hapi edhe qeshtjen e mbeshtes se sipermarrjeve te vogla dhe te mesme ne Serbine Jugore. Eshte paralajmeruar edhe takimi me afaristet ne prill te vitit 2009 nen organizimin e Odes Ekonomike te Serbise si dhe hapja e zyres se Odes Ekonomike te Serbise.
- Ne bashkepunim me Fondin per Zhvillim, Trupi Koordinues bashkepunon me kompanine Biomelem ne arritjen e hapjes se nje linje te re te prodhimeve te saj ne Bujanoc. Nese vie deri te realizimi i ketij projekti, ne Bujanoc do te hapen 50 vende te reja pune per qytetaret e Bujanocit.

Nga sfera e integrimeve:

- Njeri nder problemet me te medha eshte perfaqsimi i shqipetareve ne organet shteterore si: ne gjyqesi, kataster, organet tatumore, elektridistribucion, dogana etj. Perparim evident ka vetem ne organet e policise dhe te shendetesise.
- Duke pasur parasysh keto kerkesa, Trupi Koordinues organizoi viziten e perfaquesuesve relevant nga Beograd. Ne delegacion me sekretarin shteterore te Ministrise se Drejtisise Slobodan Homen, kryetari i Trupit Koordinues paraqiti problemin e integrimit te Shqipetareve ne organet e drejtisise. Pas ketij takimi, delegacioni i Ministrise se Drejtisise dhe Trupit Koordinues vizitoi perseri komunat e Bujanocit dhe Presheves ku vie deri te marreveshja rreth mundesise se dhenies se provimit te jurispodences ne Bujanoc ne menyre qe te kemi jurist te afte per punesim ne baze te ligjit te reformuar ne gjyqesi. Ministria e gjyqesise ne bashkepunim me Trupin Koordinues gjate janarit punesoit nje shqipetare ne detyren e bashkepunterorit per kundervajtje. Problemet tjera me Ministrine e Drejtisise, Trupi Koordinues do t'i zgjidhe ne menyre te kontinuar.

Ne bashkepunim me zyren per mbrojtjen e qytetareve Sasha Jankovic, vie deri te marreveshja e hapjes se zyres se Ombudsmanit ne Bujanoc ne gjashtemujorin e pare te vitit 2009. Ne zyren per mbrojtjen e qytetareve do te punesohen perfaquesuesit e te gjithe grupeve etnike nga Serbia Jugore.



Република Србија

Координационо тело Србије за општине Прешево, Бујановац и Медвеђа

- Trupi koordinues bashkepunon me Ministrine e Shendetesise ne permiresimin e kushteve te punes se Shtepive te shendeteit ne Presheve si dhe ne hapjen e nje reparti gjinekologjik per lindje per arsy se kjo komune ploteson kushtet ligjore.
- Ne tetore te vitit 2008, Qeveria e republikes se Serbise, nen propozimin e Trupit Koordinues ka marre vendim per pranimin e diplomave te studenteve te Univerzitetit te Prishtines por vetem te atyre diplomave ku figuron vula e UNMIK-ut
- Trupi Koordinues ne tetore te vitit 2008 ne bashkepunim me Ministrine e arsimit, filloj projektin e hapjes se paraleleve te ndara te Fakultetit Ekonomik dhe atij te Drejtësise pran Univerzitetit te Nishit ne komunen e Medvegjes. Fakultetet do te hapan edhe ne komunat e Presheves dhe Bujanocit. Trupi Koordinues eshte ne bashkepunim e siper edhe me USAID-in rreth perkthimit te teksteve mesimore ne gjuhen shqipe. Hapja e fakulteteve ne Presheve dhe Bujanoc pas Medvegjes eshte hap i rendesishem strategjik ne arsimimin kualitativ ne gjuhen shqipe dhe serbe. Hapja e faulkteve do te kete edhe rendesi te madhe ne zhvllimin ekonomik te ketyre tri komunave.
- Trupi Koordinues bashkepunon edhe me partneret nga sektori joqeveritare rreth perpilimit te studios se zbatueshmerise rreth hapjes se fakultetit ne Presheve dhe Bujanoc.
- Nen inisiativen e Trupit Koordinues, perfaqesuesit e 11 prodhuesve te kompjuterave, ne bashkepunim me zyren e Microsoft-it ne Serbi, ne nentore te vitit 2008 shkolles fillore „Branko Radiqeviq“ ne Bujanoc ku vijojne 1450 nxenes i dhuroi 30 kompjutere dhe 4 printerat.
- Ne buxhetin e Trupit Koordinues per vitin 2009 per here te pare jane parapare mjete per pune me rinine dhe projekte rinore me vlore prej 21.5 milione dinare. Mjetet e larteppermendura do t'u dodikohen rinise dhe shoqerise civile.
- Ne bashkepunim me Ministrine e kultures. Trupi Koordinues ka parapare angazhimet e saj ne projekte te cilat do te kene karakter kulturore ne te cilin do te marin pjese perfaqesuesit e te gjitha komuniteteve qe jetojne ne keto treva, projekte keto shume te rendesishme per integrim.
- Eshte prapare bashkepunimi me Ministrine e punes dhe te ndihmes sociale ne sigurimin e mjeteve per ndihme personave te moshuar si dhe personave me aftesi te kufizuara.

Ne raportet nderkombetare:

- Trupi Koordinues duke e mare parasysh rendesine e partneritetit me organizaten nderkombetare, vendose komunikimin intenziv me perfaqesuesit e organizatave nderkombetare duke perfshire:
 - (a) Drejtori i sherbimit te Trupit Koordinues, Nenad Gjurgjeviq te enjten me 19 shkurte te vitit 2009 takohet me Komisarin e Larte te OSBE-se per pakica kombetare Knut Volebekun. Ne takim mori pjese edhe ambasadori i Misionit te OSBE-se ne Bg Zoteri Hans Ola Urstad. Ne takim eshte biseduar mbi situaten ne Presheve dhe Bujanoc, formimin e qeverisjes multietnike ne Bujanoc dhe Presheve, permiresimin e kushteve



Република Србија

Координационо тело Србије за општине Прешево, Бујановац и Медвеђа

te shkollimit te pakicave si dhe perpilimin e analizes e cila do te mundesoje qe te vije deri te hapja sa me e shpejte e shkollave te larta ne Presheve dhe Bujanoc.

- (b) Komunikimin e perhershem me Ambasadorin e OSBE-se Hans Ola Urstad
 - (c) Komunikimin e perhershem me Agjensionin Amerikan per zhvillim nderkombetare (USAID) dhe takimet me Ambasadorin e SHBA-se ne Serbi, Kameron Monter, ne shkembimin e informacioneve rreth situates ne Serbine Jugore si dhe planet e perbashketa mbi hapjen e shkollave te larta ne komunat e Presheves, Bujanocit dhe Medvegjes.
 - (d) Komunikimi me perfaqesuesit e ambasades se Federates Ruse si dhe vizita e pare e ambasadorit Rus Aleksander Konuzin komunave te Bujanocit dhe Presheves me perfaqesuesit e Trupit Koordinues.
 - (e) Komunikimi me ambasadat e Britanise se Madhe, Italise, Frances dhe Rumanise.
-
- Trupi Koordinues merr aktivisht pjese ne perpilimin e projektit te ri te UNDP-se i cili do te filloje me realizimin e saj ne komunat e Regionit te Pqinjes dhe te Jabllanices gjate vitit 2009, qe ky projekt ne menyre sa me efikase t'i permbushe kerkesat dhe nevojet e qytetareve te kesaj treve.
 - Trupi Koordinues bashkepunon me CSSP-ne, Projekt per integrimin meditativ nga Berlini si dhe Fondacionin Konrad Adenauer ne fillimin e projekteve meditative si menyre kunder konflikteve multietnike ne komunat e Presheves, Bujanocit dhe Medvegjes.
 - Trupi Koordinues ka perfshire komunat e Presheves, Bujanocit dhe Medvegjes ne programin „Transferi i diturise ne administraten komunale ne Serbi ne sferen e TQM-se (Total Quality Management)-sistemi i administritimit komunal“ e cila finansohet nga ambasada Hungareze ne Beograd. Ky system aplikohet ne administratat komunale ne suaza te Unionit European dhe kjo do te jete hera e pare qe ky system te prezantohet ne Serbi. Trajnim i do te t'u mundesoje administrates komunale te Presheves, Bujanocit dhe Medvegjes te kene qasje se si duhet te duket sherbimi i punetoreve administrativ ndaj qytetareve dhe me kete te ndikojne ne permiresimin e kualitetit te jetes se tyre.

Ne komunikimin publik:

- Trupi Koordinues paraqet publik raportin e tije te trete gjashtemujore (ne menyre qe qytetaret te jene sa me te informuar rreth punes se tyre mirepo edhe per komunikimin sa me te mire me ministrite dhe agjensionet e Qeverise se Republike se Serbie si dhe me partneret e tyre nderkombetare). Raporti dergohet ne me se 300 adresat te partnereve lokal dhe nderkombetare dhe kushdo qe te ket interes per kete report ne qdo kohe munde ta lexoje ne web faqen e Trupit Koordinues ne adresen www.kt.gov.rs
- Menjehere pas emerimit te tije per kryetare te Trupit Koordinues, Milan Markovic ka derguar leter qytetareve te komunave te Presheves, Bujanocit dhe Medvegjes me ane te se cilave u prezanton qellimet e punes se Trupit Koordinues si dhe planet e ardhshme te Trupit Koordinues.
- Nga emerimi e tij per kryetare te Trupit Koordinues, dy here u eshte drejtuar me shkrim keshilletareve te Komunave te Presheves dhe Bujanocit qe ne punen e tyre komunale te kene parasysh angazhimet dhe planet e Trupit Koordinues si dhe marreveshje ne mes



Република Србија
Координационо тело Србије за општине Прешево, Бујановац и Медвеђа

Trupit Koordinues dhe komunave per formimin e nje qeverie multietnike ne keto dy komuna.

- Sherbimi i Trupit Kjoordinues ne fillim te vitit 2009 ka vene ne fungsion web faqen e re, ne menyre qe qytetaret te kene qasje sa me te mire dhe me te lehte ne informimin e tyre rreth punes se Trupit Koordinues si dhe te komunikojne me Sherbimin e ketij Trupi.

Qellimi i Trupit Koordinues eshte qe permes partneritetit me ministrite e Qeverise se Republike se Serbie, organizatat nderkombetare si dhe me partneret tjere relevant, te ndikoje ne zhvillimin ekonomik te komunes se Presheves, Bujanocit dhe Medvegjes. Trupi Koordinues perpiqet te perparoje kapacitetet e qeverisjes lokale si dhe shoqerise civile ashtuqe ato vete te kene mundesi ne zhvillimin ekonomik te tyre pa u mbeshtetur ne ndihmat afateshkurtera te cilat ndihma nuk kan efekt ne nje periudhe me te gjate kohore ne zhvillimin ekonomik dhe e cila nuk ndikon ne eliminimin e varferise se qytetareve ne keto tri komuna.